



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10-20/2018 regjistër (JR)
Datë 07.04.2021

Nr. 34 i vendimit
Datë 06.12.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.12.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen që i përket:

KËRKUESE: Rovena Gashi, e bija e N., e datëlindjes {***}, lindur në Durrës e banuese në Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12, datë 29.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 494, 495, 496, 497, 498, 498/a të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e kërkuases, në kërkesat e paraqitura prej saj dhe në parashtrimet me shkrim, e cila përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 12, datë 29.05.2019, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Znj. Rovena Gashi (në vijim “kërkuesja”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 48, datë 25.07.2018 (në vijim “vendimi nr. 48/2018”), vendosi shkarkimin nga detyra të znj. Rovena Gashi, me funksion prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Këtë vendim kërkuesja e ankimoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili me vendimin nr. 12, datë 29.05.2019 (në vijim “vendimi 12/2019 (JR)”) vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Në vijim, kërkuesja Rovena Gashi ka paraqitur në Kolegj pesë kërkesa për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 12/2019 (JR), sipas objektit të referuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, regjistruar si vijojnë:
 - (i) më datë 07.04.2021, regjistruar në Kolegj me nr. 10-20/2018 (JR);
 - (ii) më datë 20.10.2021, regjistruar në Kolegj me nr. 16-20/2018 (JR);
 - (iii) më datë 06.02.2023, regjistruar në Kolegj me nr. 30-20/2018 (JR);
 - (iv) më datë 24.04.2023, regjistruar në Kolegj me nr. 58-20/2018 (JR);
 - (v) më datë 27.10.2023, regjistruar në Kolegj me nr. 204/232 prot.
3. Në seancën gjyqësore të datës 03.11.2023, në dhomë këshillimi, për shqyrtimin e kërkesës për rishikim, të regjistruar në Kolegj me nr. 10-20/2018 (JR), datë 07.04.2021, në zbatim të nenit 448 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit i shortuar, vendosi bashkimin në një proces të vetëm të kërkesave të ardhura më pas [të referuara më sipër], pasi konstatoi se ato [kërkesat] kanë të njëjtin objekt, e konkretisht, rishikimin e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

II. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

4. Në vendimin nr. 12/2019 (JR), që përbën objekt kërkesash për rishikim, Kolegji ka konkluduar për lënien në fuqi të vendimit nr. 48/2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, pasi ka konstatuar se: *Subjekti i rivlerësimit ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht; deklarimi për këto pasuri është kryer në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë; dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.*

III. Kërkesat e paraqitura në Kolegj dhe shkaqet e ngritura nga kërkuesja

5. Në kërkesën *e parë*, znj. Rovena Gashi ka kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit, me pretendimin se një prej anëtarëve të trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e saj në Kolegj, ka kryer një vepër të dënueshme penalisht, gjë që ka ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e saj të rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e nenit 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka gjetur fajtor të pandehurin L. D. [me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020], për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky i fundit përbën mbështetje të kërkesës për rishikim.
6. Në kërkesën *e dytë* për rishikim, kërkuesja pretendon se Kolegji, duke prishur vendimin e Komisionit dhe kthyer çështjen për kryerjen e procesit të rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera në Komision, në vendimin nr. 14/2021 (JR), datë 15.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. B., ka ndryshuar praktikën gjyqësore e, për rrjedhojë, qëndrimin e mëparshëm të Kolegjit, sipas të cilit kishte konsideruar të drejta vendimmarrjet e Komisionit, bazuar në hetimin administrativ të përfunduar vetëm me një kriter. Për sa më lart, kërkuesja pretendon se nëpërmjet një interpretimi të ri të kompetencave kushtetuese të Kolegjit dhe Komisionit, asaj i lind e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas përcaktimeve të nenit 494, germa “d” e Kodit të Procedurës Civile.
7. Në kërkesën *e tretë*, kërkuesja ka pretenduar se vendimi përfundimtar i GjEDNj-së i datës 04.10.2022, që i përket çështjes *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, përbën një provë të re me shkresë që ka shumë rëndësi për çështjen, pasi ka rezultuar i vërtetuar fakti juridik se anëtari i trupit gjykues, z. L. D., nuk përmbushte kushtet ligjore për emërimin e tij si gjyqtar i Kolegjit. Ky fakt, parashtron kërkuesja, nuk ka qenë i konstatuar nga asnjë autoritet tjetër shtetëror vendas, gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes së kërkueses Rovena Gashi. Sipas kërkueses, ky fakt përbën shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së. Për sa më sipër, kërkuesja bazohet në parashikimet e nenit 494, gjerat “a” dhe “ë” të Kodit të Procedurës Civile.
8. Në kërkesën *e katërt*, kërkuesja ka parashtruar se fakti që një prej anëtarëve të trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e saj në Kolegj, ka kryer një vepër të dënueshme penalisht, ka ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e saj të rivlerësimit në kuadër të përcaktimeve të nenit 494, gjerat “a” dhe “c” të Kodit të Procedurës Civile dhe i krijon të drejtën asaj për të kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit. Ky kërkim bazohet në vendimin e datës 21.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimet e dy gjykatave më të ulëta që kanë gjetur fajtor z. L. D. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.

9. Në kërkesën e saj të pestë, kërkesja parashtron se, meqenëse Gjykata e Lartë¹ ka lënë në fuqi vendimet² e dy gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që kanë shpallur të pafajshme anëtarin e Komisionit E. Ç., duke pranuar si të vërteta deklaratimet e saj gjatë procedimit penal, vendimi gjyqësor penal i formës së prerë përbën një provë të re me shkresë, e cila nuk mund të dihej nga ajo [kërkesja] gjatë shqyrtimit të çështjes së saj në Kolegj, ku zbulohen rrethana të reja të bëra nga ana e gjykatës mbi saktësinë, plotësinë dhe ligjshmërinë e deklaratimit të një pasurie. Si rrjedhojë, znj. Gashi pretendon se në bazë të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, asaj i lind e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Po ashtu, në zbatim të leximit harmonik e integral të dispozitave të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kolegji zbaton edhe dispozitat procedurale administrative e ato civile, kur është rasti. Nën dritën e këtyre parashikimeve, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për gjykatën që shqyrton kërkesat për rishikim, e konkretisht nenin 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile³, kërkesa e znj. Rovena Gashi për rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit objekt rishikimi, u mor në shqyrtim nga Kolegji, si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

¹ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.09.2023, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 12.01.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

² Vendimi nr. {***}, datë 16.09.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka deklaruar të pafajshme znj. E. Ç., i cili është lënë në fuqi nga vendimi nr. {***}, datë 12.01.2023, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

³ “1. Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkaku për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494 të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës ose marrjes së dokumenteve [...]”.

ii. *Legjitimimi i kërkueses*

11. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të kërkesës*

12. Në përputhje me nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴, verifikimi i legjitimitetit të kërkuesit, bazueshmëria në ligj dhe në prova e kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe prania e kriterëve ligjore për shqyrtimin e saj, kryhet në dhomë këshillimi.

B. *Arsyetimi i Kolegjit mbi kërkesat për rishikim*

i. *Kërkesa e parë për rishikim*

13. Në kërkesën e parë për rishikim, znj. Gashi ka parashtuar si bazë situatën ligjore sipas përcaktimeve të nenit 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, duke iu referuar vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpërmjet të cilit është deklaruar fajtor [i pandehuri] L. D.. Konkretisht, kërkesa për rishikim argumenton se meqenëse relatori i trupit gjykues që ka gjykuar në Kolegj çështjen e saj të rivlerësimit, z. L. D., është dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, kjo situatë ka ndikuar në dhënien e vendimit me të cilin është shkarkuar nga detyra kërkuesja. Po ashtu, ajo potencon se për shkak të misionit që ka Kolegji për kthimin e besimit të publikut te drejtësia, legjislacioni i brendshëm ka parashikuar një proces mjaft rigoroz emërimi, në të cilin janë përcaktuar kriteret që duhet të plotësojnë gjyqtarët e tij [Kolegjit], për të garantuar integritetin, pavarësinë dhe paaftësinë e tyre, në funksion të garantimit të gjykatës së krijuar me ligj dhe për dhënien e vendimit të drejtë. Në kushtet që dy gjykata të brendshme kanë konstatuar faktin se nuk është respektuar ligji gjatë procedurës së aplikimit, përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarit të Kolegjit, z. L. D., dhe që ai nuk plotësonte kriteret ligjore për t’u emëruar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, për shkak të shkarkimit të mëparshëm nga detyra [e gjyqtarit] për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë, fakti që funksioni është marrë në kushtet e kryerjes së një vepre penale, sipas kërkueses, ka ndikuar në dhënien e një vendimi të padrejtë ndaj saj, në privim të së drejtës së saj për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj.

- 13.1. Bashkëngjitur kësaj kërkesë, znj. Gashi ka paraqitur tri akte⁵ dhe ka kërkuar:

⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 25.02.2009.

⁵ Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që vendosi shkarkimin e saj nga detyra [nr. 48, datë 25.07.2018], vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit [nr. 12/2019 (JR)] që la në fuqi vendimin e Komisionit dhe vendimi [nr. {***}, datë 01.12.2020] i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

(1) Pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

(2) Rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi me vendimin nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

13.2 Pasi analizoi kërkimet e znj. Gashi nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore të parashikuara nga germa “c” e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, në kushtet që në rrethanat e parashtruara nga kërkuarja nëpërmjet dy vendimeve penale, nuk përmbushet asnjë nga dy kriteret kumulative që parashikon kjo dispozitë si kusht [*conditio sine qua non*] për rishikimin, kryerjen e një vepra penale të dënueshme penalisht, në rastin konkret nga gjyqtari, e që [vepra penale] të ketë “ndikuar në dhënien e vendimit” për të cilin kërkohet rishikim, trupi gjykues e vlerëson të papranueshme kërkesën. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

13.3. Pikësëpari, nga interpretimi harmonik i gjuhës së përdorur nga ligjvënësi në këtë dispozitë me natyrën dhe konceptin e rishikimit si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, në kontekstin e rëndësisë që ka siguria juridike në një shoqëri demokratike, dhe balancën mes të drejtave themeltare të individëve dhe të interesit publik, deduktohet një gjendje në të cilën legjislatori ka parashikuar në mënyrë të shprehur rrethanat përjashtuese [nga rregulli], në të cilat rishikimi mund të kërkohet apo pranohet. Secila prej situatave analizohet kundrejt efektit që ka mbi vendimin që ka marrë formë të prerë, për të cilin kërkohet rishikim, e për të cilin kanë dalë fakte të reja apo janë vërtetuar rrethana që tregojnë se vendimi për të cilin do të kërkohet rishikim, mund të kishte potencialisht një zgjidhje tjetër⁶. Në asnjë prej tyre, ligji nuk u referohet ndodhive, fakteve apo rrethanave të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë apo janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi.

13.4. Nga ky lexim rezulton se në mënyrë që vepra penale për të cilën anëtar i trupit gjykues është gjetur fajtor të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari/gjyqtarja ka marrë vendimin, vullneti i tij/saj është vesuar për shkak të një vepra penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. E thënë ndryshe, duhet të ketë një lidhje shkakësore mes sjelljes së papërshtatshme, ndikimit të paligjshëm apo një veprimi tjetër volutiv të gjyqtarit dhe vendimit për të cilin kërkohet rishikim. Lidhja shkakësore do të duhet të ishte e natyrës psikologjike e të vullnetit që lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e

⁶ Neni 494, paragrafi II, parashikon: “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj; b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme; c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara; d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur; e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë, të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak; ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë [...]”.

vendimmarrjes. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari/gjyqtareje në shkelje të parimeve të paanësisë e objektivitetit, provuar nga një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime, është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNJ-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”⁷.

13.5. Në rrethanat faktike konkrete, siç rezulton edhe nga aktet e paraqitura nga kërkuesja, është përtej çdo kontesti që vepra penale për të cilën është dënuar penalisht z. L. D.⁸, nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin e marrë në Kolegj për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit që e shkarkoi atë [kërkuesen] nga detyra. Së pari, në planin kohor, vepra penale e falsifikimit për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., referuar vendimeve të gjykatave, është kryer në vitin 2017, në procesin e kandidimit për pozicionin në të cilin më pas është emëruar, ndërsa vendimi i Kolegjit për të cilin znj. Gashi kërkon rishikimin është marrë në maj 2019, mbi dy vite pasi është konsumuar vepra penale që përbën bazën e kërkesës për rishikim. Së dyti, në planin e lidhjes shkakësore, qartazi nuk mund të argumentohet ndonjë lidhje shkakësore mes veprimeve të kryera në procesin e kandidimit e emërimit të gjyqtarit në vitin 2017, dhe atyre të kryera prej tij në procesin e shqyrtimit të ankimit të kërkueses, në funksion të kryerjes së detyrave përkatëse, qofshin ato edhe detyra të cilat janë tagër e relatorit, si një ndër pesë (5) anëtarët e trupit gjykues, që vendosi në mënyrë unanime lënien në fuqi të shkarkimit të kërkueses. Nën dritën e kësaj analize, është i pabazuar, sikurse edhe i pakuptimtë, pretendimi se vepra penale e konstatuar nga gjykata ka ndikuar në mënyrën sesi z. D. ka votuar në çështjen në Kolegj, mbi bazën e ankimit të kërkueses.

13.6. Kërkuesja nuk ka potencuar asnjë lidhje shkakësore sipas arsytimit që dikton dispozita mbi të cilën bazohet kërkesa e saj. Në kërkesën për rishikim, znj. Gashi pretendon se fakti që z. L. D. është emëruar pa plotësuar kriteret ligjore të përcaktuara me ligj, ka sjellë si pasojë dhënien e një vendimi të padrejtë, si dhe i ka mohuar gjykimin nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj. Me fjalë të tjera, ndonëse kërkesa për rishikim referon germën “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesja në fakt e argumenton dënimin penal në ngarkim të z. D., në drejtim të parimeve për gjykim të rregullt, sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “Konventa Evropiane”). Në këto kushte dhe në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e vlerëson të pakontestuar edhe nga kërkuesja konkluzionin e mësipërm për mungesë baze ligjore për rishikimin e vendimit sipas parashikimit ligjor që kërkon ekzistencën e lidhjes shkakësore mes vendimit penal në ngarkim të gjyqtarit e vendimit të marrë për ankimin e saj në Kolegj. Nga ana tjetër, pretendimi i kërkueses se pjesëmarrja e gjyqtarit L. D. në trupën gjyqësore të Kolegjit që gjykoi ankimin e kërkueses kundër vendimit të Komisionit, e privoi kërkuesen nga e drejta për t’u gjykuar nga

⁷ *Shih Brumarescu kundër Rumanisë, Pravednaya kundër Rusisë* parag. 25, *Bratyakin kundër Rusisë*, ndër të tjerë.

⁸ Referuar vendimit të mësipërm të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i pandehuri L. D. u deklarua fajtor për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe u dënua me gjashtë muaj burgim.

një “gjykatë e krijuar me ligj”, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNj-së, analizohet në vijim, në paragrafin 16, lidhur me kërkesën e katërt të saj.

13.7. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se kërkesja nuk arriti të provojë ndikimin e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor anëtari i trupit gjykues që shqyrtoi ankimin e saj në Kolegji, në vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, sipas parashikimeve të nenit 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, sikurse shtjelluar më sipër, kërkesa për rishikim nuk mund të pranohet. Nën dritën e parashikimeve të nenit 498, pika 1⁹ e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerësoi se kërkesa e parë e kërkueses Rovena Gashi, me objekt rishikimin e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk duhet të pranohet.

ii. *Kërkesa e dytë për rishikim*

14. Në kërkesën e saj të dytë për rishikim, kërkuessa pretendon se nëpërmjet vendimit nr. 14/2021¹⁰, pasi Komisioni kishte vendosur shkarkimin për kërkuessen, lënë në fuqi nga vendimi objekt rishikimi, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka ndryshuar qëndrimin që kishte mbajtur më parë për çështje të ngjashme sikurse edhe praktikën e tij gjyqësore të deriatëhershme, duke orientuar ndryshe Komisionin. Sipas znj. Gashi, nëpërmjet këtij vendimi, Kolegji ndryshoi praktikën gjyqësore të deriatëhershme duke prishur një vendim të Komisionit që bazohej vetëm në një ndër kriteret e rivlerësimit. Mbi bazën e këtij konkluzioni të potencuar prej saj, kërkuessa shprehet se i lind e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë sipas përcaktimeve të nenit 494, germa “d” e Kodit të Procedurës Civile, pasi një interpretim i ri i kompetencave të Kolegjit dhe Komisionit në një çështje tjetër, prish qëndrimin e mbajtur në çështjen e kërkueses (Rovena Gashi), në rivlerësimin e së cilës Kolegji dhe Komisioni kanë bazuar vendimin e shkarkimit mbi vlerësimin e një kriteri të vetëm [atë të pasurisë].

14.1. Në përputhje me përcaktimet e nenit 497, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, kërkuessa ka argumentuar se Kolegji ka kompetencën lëndore për rishikimin e këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë, pasi është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar në themel ankimin e saj ndaj vendimit të Komisionit, dhe kërkon:

(1) Pranimin e kërkesës së saj për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi me vendimin nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

(2) Kalimin për shqyrtim në seancë publike të çështjes për administrimin e provave të paraqitura nga kërkuessa bashkëlidhur kërkesës.

(3) Prishjen e vendimit nr. 48/2018 të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi.

⁹ “1. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj [...]”.

¹⁰ Vendimi 14/2021 (JR), datë 15.06.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i publikuar i arsyetuar në datën 20.09.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B..

(4) Urdhërimin e Komisionit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për kërkuesen Rovena Gashi edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Bashkëngjitur kësaj kërkesë, znj. Gashi, përveç vendimeve të Komisionit dhe të Kolegjit për çështjen e saj të rivlerësimit, ka paraqitur edhe vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., mbi të cilin mbështetet kjo kërkesë për rishikim.

14.2. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se kërkesa e dytë për rishikim e parashtruar nga znj. Gashi është haptazi e pabazuar në ligj. Si e tillë, ajo nuk pranohet, nën dritën e parashikimit të nenit 498, pika 1¹¹ e Kodit të Procedurës Civile. Ky konkluzion mban për bazë jo vetëm interpretimin e gabuar në tërësi të kërkueses për mënyrën e disponimit të trupit gjykues të Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., por edhe konstatimin që baza ligjore e cituar nga kërkuesja, germa “d” e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, haptazi nuk gjen zbatim, në kushtet që dispozita e referuar prej kërkueses parashikon rishikimin nëse vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose një institucioni tjetër që më pas është prishur¹². Analizuar në kontekst të secilit prej këtyre dy këndvështrimeve, kërkesa e znj. Gashi është haptazi e pabazuar. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

14.3. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se me vendimin që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., kundër vendimit të Komisionit që vendosi shkarkimin e saj¹³, trupi gjykues i Kolegjit ka vendosur¹⁴:

“1. Të prishë vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 109, datë 19.02.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B..

2. Të urdhërojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. I. B., edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale [...]”.

Pika 1 e këtij dispozitivi, sikurse citohet, përmban konkluzionin e [shumicës së] trupit gjykues të Kolegjit, shtjelluar në paragrafin 102, në të cilin arsyetohet që “subjekti i rivlerësimit, znj. I. B., ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””. Po aty, trupi gjykues i Kolegjit ka disponuar se në kushtet që hetimi administrativ për atë subjekt rivlerësimi dhe vendimi i shin marrë vetëm mbi bazën e një kriteri të rivlerësimit [atij të pasurisë], dhe pasi ajo arriti nivel të besueshëm për atë kriter në Kolegji – duke përmbysur në këtë mënyrë zgjidhjen përfundimtare të Komisionit – duhej të kryejë hetimi i dy kriterëve të tjera për shkak të parashikimit në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili dikton që subjektet mund të konfirmohen në detyrë pasi kalojnë me sukses vlerësimin në të tria kriteret.

¹¹ Shih më sipër, përmbajtjen e pikës 1 të nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile.

¹² Neni 494, paragrafi II, germa “d” përcakton që: “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur [...]”.

¹³ Vendimi nr. 14/2021 (JR), datë 20.10.2021: https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi_I.-B._perفشire_mendim_pakice_anonimizuar.pdf.

¹⁴ Si më sipër, faqe 33 e vendimit të Kolegjit.

14.4. Me fjalë të tjera, vendimi i sipërreferuar, që përbën fokusin e kërkesës së dytë për rishikim, jo vetëm që nuk mund të argumentohet, qoftë edhe teorikisht, se përbën ndryshim interpretimi nga Kolegji, por konfirmon që nëse nga kontrolli i ushtruar në Kolegj rezultoi i pabazuar vendimi i Komisionit dhe subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vetëm të hetuar – në rastin konkret, në vlerësimin e kriterit të pasurisë – Komisioni duhet të kryejë hetimin administrativ për një ose dy kriteret e tjera, në bazë të leximit të kombinuar të parashikimeve të nenit 4, pika 2¹⁵ dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Ligji lejon vendimmarrjen mbi bazën e një ose disa kriterëve, sikurse vlerësimin e përgjithshëm të procedurave, ndërkohë që për konfirmimin në detyrë, duhet të plotësohen së bashku tri kushtet që përkohë me vlerësimin pozitiv për secilin prej kriterëve të rivlerësimit¹⁶, sikurse edhe të mos gjejë zbatim rasti i cenimit të besimit të publikut, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.5. Situata e kërkuës do të kishte teorikisht analogji me atë të konstatuar nga Kolegji në çështjen e subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., vetëm nëse në vendimin për të cilin kërkohet rishikim, Kolegji do të kishte konstatuar që znj. Gashi kishte arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë e, për pasojë, do të bëhej i nevojshëm hetimi për dy kriteret e tjera. Në rrethanat konkrete, trupi gjykues i Kolegjit ka konkluduar se [subjekti i rivlerësimit] Rovena Gashi nuk ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë në kushtet që është konstatuar se [ajo] ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016¹⁷. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionit për shkarkimin e kërkuës mbi bazën e kriterit të vlerësuar. Me fjalë të tjera, ndërsa për subjektin e rivlerësimit, znj. I. B., Kolegji ka kryer vlerësim pozitiv për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimin për znj. Gashi, vlerësimi nuk ka pasur rezultat pozitiv. Për pasojë, ndërsa për znj. B. nevojitej hetimi i kriterëve të tjera, për znj. Gashi në kushtet e vlerësimit negativ, vlerësimi i kriterëve të tjera nuk do të passillte një zgjidhje tjetër të çështjes gjithësesi. Në kushtet kur konfirmimi në detyrë, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kërkon plotësimin me sukses të kontrollit në të tria kriteret, ndërsa moskalimi me sukses i qoftë edhe njërit prej kriterëve është shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, hetimi për kriteret e tjera është parë i panevojshëm nga legjislatori, në dritën e efikasitetit të procesit dhe të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

14.6. Për rrjedhojë, argumentet për të zbatuar dispozitën e germës “d” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile për rishikim, e konkretisht, për vendim të bazuar mbi një vendim të

¹⁵ Neni 4, pika 2 parashikon: “[2.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”.

¹⁶ Neni 59, pika 1 parashikon: “1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...]”.

¹⁷ Paragrafi 27 i vendimit të Kolegjit (JR) nr. 12/2019: https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendimi_12_29.5.2019_SR_Rovena_Gashi.pdf.

prishur, janë alogjike, përpos që nuk pasqyrojnë realitetin. Në kushtet që Kolegji ka lënë në fuqi dhe jo prishur vendimin e Komisionit për rivlerësimin e kërkueses, pretendimi se gjen zbatim shkaku i rishikimit për një vendim të prishur në një çështje tjetër, të palidhur me atë të kërkueses, është i pakuptimtë dhe i pabazuar. Nëse do të ndiqej logjika e propozuar nga kërkuësja, teorikisht do të kishte vend prezumimi i pretenduar prej saj se Kolegji ka ndryshuar interpretimin apo udhëzimin që i jep Komisionit në çdo rast në të cilin është disponuar me ndryshim të vendimeve të Komisionit, duke konfirmuar në detyrë apo shkarkuar nga detyra subjekte të ndryshme, pas majit 2019 [koha kur është shpallur vendimi për të cilin kërkohet rishikim]. E thënë me fjalë të tjera, duke pasur parasysh që neni 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon tri mënyra disponimi për vendimmarrjet e Kolegjit – lënien në fuqi, ndryshimin dhe prishjen e vendimit të Komisionit – logjika e pretenduar nga kërkuësja për ndryshim interpretimi do të duhet të gjente zbatim edhe për disponimin tjetër, konfirmimin në detyrë.

14.7. Përpos këtij konkluzioni, dhe si konstatim i përgjithshëm, trupi gjyqësor çmon të theksojë edhe që nëse çfarë pretendon kërkuësja do të pasqyronte të vërtetën, një udhëzim i natyrës së pretenduar prej saj, dhënë nga Kolegji, do të ishte në kundërshtim të hapur me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe me praktikën e konsoliduar të tij [Kolegjit] përpara dhe pas vendimit (JR) nr. 14/2021, të marrë për subjektin e rivlerësimit, znj. I. B.. Ky fakt rezultoi edhe nga një kontroll i thjeshtë në faqen zyrtare në internet të Kolegjit, ku gjenden të publikuara vendimet e Kolegjit, ndër të cilat, një numër i konsiderueshëm përbëhet nga ato nëpërmjet të cilave është disponuar me shkarkim ose është lënë në fuqi një vendim shkarkimi i Komisionit, bazuar edhe në një kriter të vetëm.

iii. *Kërkesa e tretë për rishikim*

15. *Kërkesa e tretë* për rishikim të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [nr. 12/2019 (JR)], paraqitet nga kërkuësja bazuar në vendimin e GjEDNj-së që i përket çështjes *Besnik Cani kundër Shqipërisë*. Sipas kërkueses, vendimi në fjalë përbën një provë të re me shkresë që ka rëndësi për çështjen, pasi nëpërmjet tij ka rezultuar i vërtetuar fakti juridik që anëtari L. D. nuk përmbushte kushtet statutorë për emërimin në pozicionin e gjyqtarit të Kolegjit, fakt i cili nuk ka qenë i konstatuar nga asnjë autoritet tjetër shtetëror vendas, qoftë ai disiplinor apo gjyqësor, gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes së kërkueses Rovena Gashi. Ky fakt, sipas kërkueses, tregon për shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së. Asnjë autoritet vendas nuk e ka shqyrtuar dhe nuk e ka korrigjuar aspektin që ka të bëjë me emërimin e z. L. D. në Kolegji në kundërshtim me ligjin vendas, referuar vendimit të GjEDNj-së. Për sa më sipër, kërkuësja bazohet në parashikimet e nenit 494, germat “a” dhe “ë” të Kodit të Procedurës Civile.

15.1. Bashkëngjitur kësaj kërkesë, përveç vendimeve të Komisionit dhe Kolegjit për çështjen e saj të rivlerësimit, gjendet vendimi i GjEDNj-së, datë 04.10.2022, që i përket çështjes me nr. 37474/20, *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 14, datë 25.01.2023. Në përfundim, sikurse edhe në dy kërkesat e tjera, znj. Gashi kërkon:

(1) Pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

(2) Prishjen e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe vazhdimin e gjykimit në themel të çështjes që ka të bëjë me ankimin kundër vendimit nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

15.2. Së pari, sipas germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për rishikim të një vendimi të formës së prerë, kushtëzohet nga përmbushja e kriterit sipas të cilit *zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj*. Nga ana tjetër, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, rishikimi mund të kërkohej nëse *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të KEDNj-së [dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë]*. Kërkuesja argumenton se meqenëse GjEDNj-ja ka konstatuar se z. D. ishte në kushtet e pazgjedhshmërisë, një fakt juridik që nuk ka qenë konstatuar më parë nga asnjë autoritet vendas gjatë kohës që shqyrtohej ankimi i saj, është shkelur e drejta e saj për një gjykatë të krijuar me ligj, garantuar nga neni 6/1 i KEDNj-së.

15.3. Pas analizës së kësaj kërkesë nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vendosi mospranimin e saj [kërkesës], sipas parashikimeve të nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë konkluzion, trupi gjykues arriti pasi konstatoi se kërkesa gjendet jashtë rasteve të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile pasi vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Cani kundër Shqipërisë* nuk është një akt i cili mund të interpretohet si rrethanë apo provë e re me shkresë, që nuk dihej nga kërkuesja, sipas përcaktimit të germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet që nuk ka një vendim të GjEDNj-së në favor të saj (kërkueses), që përbën në thelb situatën ligjore të parashikuar nga kjo dispozitë, edhe nëse kërkesa do të ishte bazuar në germën “ë” të së njëjtës dispozitë, nuk ekzistojnë kushtet për zbatimin e kësaj të fundit në rrethanat konkrete që lidhen me kërkuesen. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

15.4. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë disa fakte me rëndësi, sikurse edhe të përthithë në arsyetim sa është shtjelluar nga GjEDNj-ja në dy çështje të rivlerësimit që gjejnë zbatim, e konkretisht, vendimet në *Cani* dhe *Sevdari*, në të cilat është elaboruar gjerësisht nga gjykata në përgjigje të pyetjeve nëse është cenuar parimi i gjykatës së krijuar me ligj, si dhe nëse kërkuesit mund të legjitimohen pa kufij kohorë për të kontestuar praninë e z. D. në trupa gjykues të ndryshëm në Kolegj. Sikurse shtjelluar gjerësisht më sipër për natyrën e jashtëzakonshme e me natyrë përjashtimore të mjetit juridik të rishikimit të vendimeve të formës së prerë, në konsideratë të parimit të sigurisë juridike, trupi gjykues i Kolegjit thekson se nga leximi sistematik i germave “a” dhe “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, dhe në harmoni me pjesët e tjera, deduktohet që provat e rrethanat e reja që parashtrohen si shkak për rishikimin, do duhet të jenë të një natyre e cila, nëse do të njihej prej gjykatës, do të passillte një vendim tjetër. Përndryshe, ky mjet ligjor mund të kishte pasoja joproductive në menaxhimin e ngarkesës së punës në gjykatë, sikurse edhe vendoste parimin e *res judicata* në pozitë të përhershme vulnerabiliteti. Me fjalë të tjera, në mënyrë që mjeti i jashtëzakonshëm t’u shërbejë interesave të drejtësisë, pa cenuar në tërësi parimet e përgjithshme themelore të saj [drejtësisë], risitë që vijnë nga provat e rrethanat e tjera, duhet të jenë të atilla që drejtësia e vendosur të prevalojë kundrejt sigurisë juridike që cenohet apo ekonomisë gjyqësore [drejtësisë]

së dhënë pa vonesë], që shoqëron si pasojë riçeljen e një çështjeje për shkak të rishikimit. Në të njëjtën linjë, edhe germa “ë” paraqitet si shërim i një situatë specifike – si mjet ligjor që gjen zbatim vetëm në ato çështje në të cilat vendimi është kontestuar me sukses dhe GjEDNj-ja ka vendosur në favor të një pale, duke e konstatuar vendimin të pabazuar. Me fjalë të tjera, si përjashtim nga rregulli dhe për të evituar dështimin në dhënien e drejtësisë, arsyetuar edhe më sipër në paragrafin 13.4 referuar GjEDNj-së në çështjen *Brumarescu* etj., ligji shqiptar ka krijuar mundësinë për zbatimin e vendimit të GjEDNj-së, nëpërmjet vënies në lëvizje të mundësisë së rishikimit, duke parashikuar këtë mjet juridik në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

15.5. Për sa më sipër, pyetjet ligjore që u shtruan në këtë analizë janë: (i) nëse vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Cani kundër Shqipërisë* përbën një provë a rrethanë të re, në kuptim të germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile dhe nëse pasoja e njohjes së mëhershme do të kishte passjellë një zgjidhje të ndryshme të çështjes; dhe (ii) nëse në kuptim të germës “ë” të së njëjtës dispozitë, vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Cani* ka efekt dhe shtrihet edhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer për subjekte të tjera.

15.6 Në rrethanat faktike konkrete, duke qenë derivat i procedimit penal dhe vendimit të gjykatës për deklarimin fajtor të z. D., pyetja e parë është e lidhur ngushtë me arsyetimin e shtjelluar më sipër në lidhje me kërkesën e parë për rishikim. Konkretisht, në kushtet që mungon një lidhje shkakësore mes vendimit të kontestuar dhe veprimeve për të cilat është dënuar penalisht ish-gjyqtari D., është e pamundur të argumentohet që nëse çfarë ka konstatuar GjEDNj-ja në çështjen *Cani*, do të ishte njohur në maj 2019 – kohën e dhënies së vendimit për kërkesën Rovena Gashi – do të përmbyste domosdoshmërisht edhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes së themelit. Me fjalë të tjera, edhe sikur të konsiderohet vendimi i GjEDNj-së në çështjen *Cani* një provë e re me shkrim – sikurse pretendon kërkesja – jo domosdoshmërisht rezultati përfundimtar në zgjidhjen e çështjes së rivlerësimit të saj do të ishte i ndryshëm nga lënia në fuqi e vendimit të Komisionit.

15.7 Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin që vendimi për të cilin kërkohet rishikim është marrë nga pesë (5) anëtarë, ndërsa problematikat e pasurisë që kanë passjellë shkarkimin, janë konstatuar e konkluduar në Komision, dhe më pas janë konfirmuar në Kolegj. Mbi të gjitha, trupi gjykues vëren se GjEDNj-ja në çështjen *Cani* ka theksuar se procesi i rivlerësimit për kërkesin [B. C.] ka në fokus të drejtat dhe përgjegjësitë e tij si prokuror karriere dhe nuk kishte ndikim/implikime, të paktën jodirekte, mbi të drejtat e detyrimet e palëve të treta¹⁸. Së fundmi, dhe po aq më rëndësi, sikurse GjEDNj-ja ka theksuar, konstatimi i shkeljes së të drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj, në rastin e çështjes së ngritur nga B. C. dhe referuar më parë edhe në çështjen e *Ástráðsson*, nuk mund të konsiderohet vetvetiu një detyrim sipas Konventës për t’i imponuar një shteti të paditur të rihapë të gjitha çështjet e ngjashme që janë bërë *res judicata* sipas ligjit të brendshëm¹⁹.

¹⁸ Paragrafi 145: <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-219773>.

¹⁹ Si më sipër, paragrafi 144.

15.8 Për më tepër, në vijim të analizës së mësipërme lidhur me sa rezulton nga gjuha dhe qëllimi i germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë arsyetimin e GjEDNj-së në çështjen *Sevdari*, për sa i përket *dijenisë* së problematikave në kriteret e zgjedhshmërisë së ish-gjyqtarit D. kundrejt pretendimit për provë të re me shkrim në formën e vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Cani*. Në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja ka konkluduar se shkarkimi i mëparshëm i z. D. ishte çështje e njohur publikisht dhe, për rrjedhojë, u ka dhënë peshë veprimeve procedurale të zgjedhura nga palët në drejtim të kontestimit të pjesëmarrjes së një gjyqtari të caktuar në procesin e tyre. Konkretisht, duke konstatuar se kërkuesja [*Sevdari*] nuk ka treguar bindshëm se nuk mund të kishte qenë në dijeni gjatë procesit të rivlerësimit për faktet kyçe që lidhen me largimin e mëparshëm të L.D. nga drejtësia, dhe që “shkarkimi i tij i mëparshëm nga detyra gjyqësore, ishte çështje publike”, GjEDNj-ja ka theksuar edhe:

“[...] nëse një palë në një proces gjyqësor ka dyshime në lidhje me ligjshmërinë e caktimit të një gjyqtari pjesëmarrës në seancën gjyqësore të çështjes së tij/saj që mund të ndikojë negativisht te cilësia “e ngritur me ligj” e asaj gjykate, në përgjithësi do të pritët që ai ose ajo t’i ngrejë këto çështje para gjykatës dhe/ose të ndjekë ndonjë mjet tjetër efektiv të parashikuar nga legjislacioni kombëtar, ndërkohë që proceset kryesore janë ende në vijim e sipër²⁰”.

15.9 Nën dritën e sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se gjatë procesit të saj të rivlerësimit, kërkuesja Rovena Gashi nuk rezulton të ketë ngritur asnjë pretendim lidhur me ish-gjyqtarin D., në drejtim të “gjykatës së krijuar me ligj”²¹. Në kërkesat e saj për përjashtim të gjithë trupit gjykues në Kolegj, kërkuesja nuk rezulton të ketë ngritur pretendime që lidhen me ligjshmërinë e caktimit të z. D. në trupin gjykues që ka shqyrtuar ankimin e saj. Në këtë prizëm, duket sikur kërkuesja mundohet të përfitojë nga mjetet e rezultuara gjatë procesit gjyqësor në GjEDNj të çështjes *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, sa i përket gjykatës së krijuar me ligj, si rrjedhojë e sa më sipër cituar, trupi gjykues vlerëson se kjo kërkesë për rishikim nuk duhet të pranohet nga Kolegji.

15.10 Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së se parimi i “gjësë së gjykuar” nënkupton që asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë vetëm për të përfituar një ridëgjim në seancë gjyqësore, një rishqyrtim dhe një rigjykim të çështjes. Kompetencat për rishikim të gjykatave më të larta, duhen ushtruar për korrigjimin e gabimeve gjyqësore dhe dështimeve në dhënien e drejtësisë, jo për të kryer një gjykim të ri të çështjes. Rishikimi nuk duhet trajtuar si një apel i fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistencës së pikëpamjeve të ndryshme në lidhje me objektin e gjykimit, nuk përbën bazë për rishqyrtim.

²⁰ Paragrafi 110 në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*:
<https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-221482>.

²¹ Shih paragrafët 13.1, 13.2. dhe 13.3 të vendimit nr. 12/2019, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, kundër vendimit të Komisionit:
https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendimi_12_29.5.2019_SR_Rovena_Gashi.pdf.

Anashkalimi i këtij parimi justifikohet vetëm kur bëhet i nevojshëm nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe detyruese²².

15.11 Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vendosi mospranimin e kërkesës së *tretë* të znj. Gashi për rishikimin e vendimit të formës së prerë, pasi vlerësoi se nuk gjejnë zbatim përcaktimet e germës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak të vendimmarrjes së GjEDNj-së në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*. Trupi gjykues vlerësoi se nuk gjen zbatim as germa “ë” e së njëjtës dispozitë dhe, për rrjedhojë, vlerësimi i kryer nga GjEDN-ja në atë çështje nuk përbën shkak për riçeljen e çështjes së subjekteve të rivlerësimit që janë bërë *res judicata* sipas ligjit të brendshëm e për të cilët nuk ka një vendim specifik nga GjEDNj-ja.

iv. *Kërkesa e katërt për rishikim*

16. Në kërkesën *e katërt* për rishikim, kërkuësja argumenton se parregullsitë në procedurën e emërimit të ish-gjyqtarit L. D., të qenit i shkarkuar më parë nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë, si dhe kryerja e një vepre të dënueshme penalisht për të siguruar riemërimin e tij në detyrën e gjyqtarit, komprometojnë legjitimitetin e trupit gjykues të çështjes së themelit të saj, ku z. L. D. ishte relator. Po ashtu, këto aspekte cenojnë parimin e gjykatës së krijuar me ligj, pavarësinë, integritetin moral, si dhe aftësinë e saj për të dhënë drejtësi, duke bërë të parregullt vetë vendimin gjyqësor, i cili duhet të rishikohet. Kërkesa referon si mbështetje nenin 494, gerrat “a” dhe “c” të Kodit të Procedurës Civile.

16.1. Për sa më sipër, në mbështetje të kërimit të saj, kërkuësja parashtrohet vendimin [nr. {***}, datë 01.12.2020] e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpërmjet të cilit është deklaruar fajtor [i pandehuri] L. D., për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, dhe është dënuar me 6 muaj burgim, lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 21.03.2023. Sipas kërkuësjes, vendimi gjyqësor i formës së prerë përbën edhe rrethana të reja, të paditura nga kërkuësja në kohën e gjykimit të çështjes së saj në Kolegj, sipas përcaktimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, për sa i përket kryerjes së një vepre të dënueshme penalisht, e cila ka ndikuar në dhënien e vendimit. Në përfundim, znj. Gashi kërkoi: (i) Pranimin e kërkesës së saj për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

(ii) Prishjen e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe vazhdimin e gjykimit në themel të çështjes së kërkuësjes, që ka të bëjë me ankimin kundër vendimit nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Bashkëlidhur kërkesës për rishikim, kërkuësja ka bashkëngjitur vendimin e Kolegjit për të cilin kërkon rishikimin, vendimet penale të tri shkallëve²³ për shpalljen fajtor të L. D., vendimin e

²² *Brumarescu kundër Rumanisë*.

²³ *Vendim nr. {***}, datë 01.12.2020, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe vendim nr. {***}, datë 26.10.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.*

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë [nr. {***}, datë 26.09.2022] dhe informacion nga faqja zyrtare në internet e Gjykatës së Lartë mbi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar [sipërcituar e referuar në poshtëshënim [në datën 21.03.2023].

16.2. Së pari, trupi gjykues vëren se kërkesja e mbështet kërkesën e saj të katërt në garancitë për një gjykatë të krijuar me ligj, parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së, ndonëse ajo shprehimisht u referohet dispozitave të germave “a” dhe “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet që aspekti që rezulton nga detyrimet që rrjedhin nga neni 6 i KEDNj-së është arsyetuar gjerësisht në lidhje me kërkesën e tretë, trupi gjykues i Kolegjit në vijim analizoi aspektet e tjera të kërkesës, sipas germave “a” dhe “c”. Nga analiza e akteve dhe pretendimeve të kërkuesses, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe kërkesa e katërt e znj. Gashi gjendet jashtë rasteve të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile e, për pasojë, nën dritën e përcaktimit të nenit 498 të të njëjtit kod, nuk pranohet. Ndonëse kërkesa e katërt në thelb fokusohet në dënimin penal të ish-gjyqtarit D., përbën një përsëritje të argumenteve të pretenduara në kërkesën e parë, e për të cilën është arsyetuar gjerësisht më sipër. Pa ripërsëritur sa analizohet në detaj e në mënyrë shteruese për nevojën e të provuarit të lidhjes shkakësore mes veprës penale për të cilën një gjyqtar është shpallur fajtor dhe vendimit për të cilin kërkohet rishikim, trupi gjykues i Kolegjit thekson se kërkesa e katërt është në të njëjtën linjë, jashtë rasteve për të cilat në mënyrë të shprehur ligji lejon rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

16.3. Konkretisht, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje që nga krahasimi i kërkesave të përsëritura për rishikim, parashtruar nga znj. Gashi, rezulton se në kërkesën e parë që mban datën 07.04.2021, parashtrohet si shkak për rishikimin e vendimit të formës së prerë, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar [datë 08.03.2021]. Në kërkesën e katërt, datë 24.04.2023, që është edhe objekt analize në këtë pjesë të vendimit, është paraqitur si shkak vendimi i Gjykatës së Lartë nëpërmjet të cilit, në datën 21.03.2023, është lënë në fuqi vendimi i sipërcituar i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për L. D.. Në këto kushte, dy kërkesat janë në thelb për të njëjtin pretendim ligjor, e konkretisht, se një anëtar i trupit gjykues të çështjes ka kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Me fjalë të tjera, kërkesa e katërt për rishikim, nuk paraqet asnjë shkak të ri kundrejt kërkesës së parë, përveçse referohet edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili në kohën kur u parashtrua kërkesa e parë nuk ishte marrë ende. Si rrjedhojë, kjo kërkesë nuk u vlerësua si kërkesë më vete.

16.4. Sikurse shtjelluar gjerësisht më sipër dhe pa hyrë në përsëritje, edhe pretendimet e kërkuesses se ajo nuk ishte në dijeni të fakteve që rezultojnë nga vendimi mbi bazën e të cilit ushtrohet kërkesa e katërt për rishikim, nuk janë të bazuara edhe për sa i përket kësaj kërkesë. Pikësëpari, sepse në vetvete, dy kërkesat adresojnë të njëjtën të dhënë e, për pasojë, mungesa e dijenisë për sa është konstatuar në shkallë të parë e të dytë, edhe duke abstraguuar nga rrethanat konkrete të çështjes, do të shtrinte ndikimin edhe mbi të dhënë që rezulton nga vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë – vlerësuar ky aspekt në drejtim të pabazueshmërisë së përsëritjes në kërkimet e ushtruara nga kërkuessja.

16.5. Pavarësisht nga sa është konstatuar më sipër dhe pa përsëritur analizën e kryer në kërkesat e tjera, mungesa e dijenisë së fakteve të konstatuara në vendimet penale të gjykatave, pretenduar nga kërkuesja në drejtim të argumentimit për ekzistencën e rrethanave të reja të cilat nuk mund të dihen prej saj, trupi gjykues rikonfirmon vlerësimin e arsyetuar gjerësisht më sipër, bazuar në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë*, lidhur me veprimet që pritet të kryhen nga palët në një proces gjyqësor nëse ushqejnë dyshime në lidhje me ligjshmërinë e caktimit të një gjyqtari pjesëmarrës në seancën gjyqësore të çështjes së tij/saj që mund të ndikojë negativisht te cilësia “e ngritur me ligj” e asaj gjykate. GjEDNj-ja ka potencuar që palët priten t’i ngrenë këto çështje para gjykatës dhe/ose të ndjekin mjetet e tjera ligjore.

16.6 Kërkuesja nuk rezulton dhe as pretendon të ketë ngritur këtë kërkim gjatë procesit të saj të rivlerësimit e as të ketë pasur ndonjë pretendim lidhur me ish-gjyqtarin L. D., si ndikim negativ në cilësinë e “gjykatës së krijuar me ligj”. Ndërkohë, sipas GjEDNj-së, pyetjet për plotësimin e kriterëve të zgjedhshmërisë së z. D. ishin të njohura publikisht dhe masa disiplinore e shkarkimit të ish-gjyqtarit L. D. në vitin 1997, nuk gjen vend as në kërkesat e saj për përjashtim drejtuar secilit anëtar të trupit gjykues gjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, edhe duke abstraguuar nga mungesa e lidhjes shkakësore që nevojitet për zbatimin e germës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, pretendimet e kërkueses për mungesë dijenie për fakte që lidhen me masën disiplinore të L. D.t, u vlerësuan se janë të pabesueshme për trupin gjykues. Prosesi i përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit është pasqyruar në mënyrë transparente, sikurse edhe dispozitat ligjore që ishin parakusht për plotësimin e kriterëve. Në këtë prizëm, trupi gjykues vlerëson se kërkuesja përpiqet të përfitojë nga elementet e rezultuara gjatë procesit gjyqësor të çështjes *Cani kundër Shqipërisë* në GjEDNj, sa i përket së drejtës për “gjykatë të krijuar me ligj”. Për pasojë, këto argumente janë të pabazuara, përpos edhe të vonuara në kohë.

16.7 Në përmbledhje e konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkuesja nuk ka provuar shkakun për të cilin është paraqitur kërkesa e katërt për rishikim sipas nenit 494, gerrat “a” dhe “c” të Kodit të Procedurës Civile. Kërkuesja nuk provoi ndikimin e veprës penale të kryer nga ish-gjyqtari L. D. në dhënien e vendimit për të cilin kërkuesja kërkon rishikimin, sikurse as rrethanën e re që përbën vendimi i Gjykatës së Lartë përkundër vendimit të shkallës së parë e të apelit për shpalljen fajtor të ish-gjyqtarit. Si rrjedhojë e sa më sipër, duke vlerësuar rrethanat e faktit në të cilin gjendet kërkuesja, trupi gjykues vlerësoi se kërkesa e katërt për rishikim, e depozituar nga znj. Rovena Gashi, nuk pranohet.

v. *Kërkesa e pestë për rishikim*

17. Në kërkesën e saj të pestë për rishikim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, znj. Rovena Gashi parashtron se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nr. {***}, datë 16.09.2022, që shpalli të pafajshme komisioneren E.

Ç.²⁴, përbën një provë të re me shkresë, e cila nuk mund të dihej nga kërkuesja gjatë shqyrtimit të çështjes së saj në Kolegj. Sipas znj. Gashi, nëpërmjet këtij vendimi penal, zbulohen rrethana të reja, si konstatime nga ana e gjykatës mbi saktësinë, plotësinë dhe ligjshmërinë e deklaramit të një pasurie. Në këto kushte, pretendon kërkuesja, në bazë të nenit 494, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, i lind e drejta për të kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

17.1 Konkretisht, kërkuesja parashtron se Gjykata e Posaçme ka justifikuar deklaramet e rreme të znj. Ç. në deklaratën e pasurisë, pasqyrimin prej saj të të dhënave të rreme në veprimet juridike të bëra para noterit, duke pranuar si të vërteta deklaramet e saj gjatë procedimit penal, me argumentin se veprimet juridike të fitimit të pronës janë kryer ndërmjet të afërmve dhe qëllimi i kryerjes së tyre ka qenë për të mundësuar marrjen e kredisë bankare për pagimin e çmimit të blerjes së apartamentit. Konstatimi i kryer nga gjykata nëpërmjet këtij vendimi penal, përmbush kushtet për t’u vlerësuar se “zbulohen rrethana të reja” mbi “saktësinë, plotësinë dhe ligjshmërinë e deklaramit të një pasurie”. Për analogji, për një ndër pasuritë objekt kontrolli gjatë procesit të rivlerësimit të kërkueses, deklaramet përputhen plotësisht me dokumentacionin e dorëzuar prej saj, ndërsa shënimi në deklaratën noteriale që blerësit kanë paguar të gjithë çmimin, ndryshe nga kontratat, është një veprim juridik i kryer ndërmjet personave me lidhje të ngushtë familjare, me qëllim mundësimin e marrjes së kredisë.

17.2. Në përfundim të kësaj kërkese, znj. Rovena Gashi kërkon:

- (i) Pranimin e kërkesës së kërkueses Rovena Gashi për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
- (ii) Prishjen e vendimit nr. 12/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe vazhdimin e gjykimit në themel të çështjes së kërkueses Rovena Gashi, që ka të bëjë me ankimin kundër vendimit nr. 48/2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

17.3 Nga analiza e akteve dhe pretendimeve të kërkueses, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe kërkesa e pestë e znj. Gashi gjendet jashtë rasteve të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile e, për pasojë, nën dritën e përcaktimit të nenit 498 të të njëjtit kod, nuk pranohet. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues vlerëson se analogjia e pretenduar mes mospërputhjeve në deklarata kundrejt akteve të fitimit të pronësisë, në çështjen e rivlerësimit të kërkueses kundrejt komisioneres Ç., nuk qëndron. Vendimi i marrë për ankimin e kërkueses nga Kolegji, për të cilin ajo kërkon rishikim, është përfundimi i një procedure administrative, në zbatim të kuadrit kushtetues e ligjor për rivlerësimin kalimtar. Vendimi i Gjykatës së Lartë në një çështje penale, bazohet në dispozitat materiale e procedurale penale, në ngarkim të një individi tjetër. Për pasojë, vendimi i Gjykatës së Lartë në çështjen e komisioneres Ç. nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikim, e as nuk mund të argumentohet si provë a rrethanë e re sipas parashikimeve të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, e as shkresë që ka rëndësi për çështjen e rivlerësimit të kërkueses. Vendimet penale në përfundim të një procedimi penal

²⁴ *Procedimi në fjalë ka nisur për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, në lidhje me një apartament banimi të ndodhur në Tiranë.*

që për pikë lidhjeje me themelin e rivlerësimit të znj. Gashi, mund të kenë vetëm deklarata pasurie, nuk paraqesin asnjë lidhje logjike, ligjore apo procedurale.

17.4 Ky vendim nuk mund të interpretohet se përbën rrethanë të re – duke abstraguar edhe nga pretendimi i kërkueses për mungesë dijenie të mëparshme – pasi mungon çdo lloj ndërvarjeje me çështjen e rivlerësimit të kërkueses Rovena Gashi. Në përmbledhje, në vendimin e referuar nga kërkuësja, është në fokus një proces penal, i derivuar nga një kallëzim penal, për një individ pasuria e të cilit nuk ka asnjë lidhje me znj. Gashi. Për pasojë, vendimi në fjalë, nuk mund të argumentohet edhe teorikisht si analogji apo jurisprudencë në Kolegj. Nëse do të pranohej logjika e kërkueses, çdo vendim i marrë nga gjykatat në procedime të pandërvarura e me natyrë thelbësisht të ndryshme garancish, si ato penale e administrative, do të mundësonte rishikimin e një vendimi të formës së prerë, duke sjellë si pasojë vendosjen e parimit të sigurisë juridike në vulnerabilitet të vazhdueshëm, edhe duke abstraguar nga detyrimet e gjykatave për të dhënë drejtësi në kohë.

17.5 Sikurse shtjelluar më sipër dhe pa hyrë në përsëritje, rishikimi përbën mjet të jashtëzakonshëm në kushtet që lejon riçeljen e një gjykimi të mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Është kjo arsyeja përse ligji parashikon rrethana shumë konkrete në të cilat, në balancën mes parimeve të së drejtës që konkurrojnë me njëra-tjetrën, lejohet riçelja e një procesi për të cilin ka vendim përfundimtar pasi pasoja që evitohet është më kritike sesa ajo që do të ndodhte në të kundërtën. GjEDNj-ja ka përcaktuar si të tillë kriter, evitimin e dështimit të drejtësisë²⁵, sikurse referuar në paragrafin 13.4 më sipër. Për këto arsye, palët mund të kërkojnë rishikim për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat nuk kishin dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit që kërkohet të rishikohet. Fakti që gjykatat vlerësojnë deklaratimet e një subjekti tjetër deklarues në një proces penal pa asnjë ndikim në çështjen e rivlerësimit të kërkueses, është e pamundur të argumentohen se përbëjnë provë/rrethanë të re në kuptim të gërmës “a” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile dhe, mbi të gjitha, të tilla që të kenë rëndësi për procedurën administrative të ndjekur nga Kolegji në shqyrtimin e ankimit të kërkueses në procesin e rivlerësimit.

17.6 Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë i dhënë për komisioneren Ç., nuk përbën rrethanë dhe as provë të re nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që i përket çështjes së rivlerësimit të kërkueses. Kërkesa për rishikim e znj. Rovena Gashi nuk gjendet e bazuar në ligj dhe, si e tillë, nuk u pranua.

- 18.** Pas shqyrtimit të pesë kërkesave, trupi gjykues i Kolegjit, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, nën dritën e nenit 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, vlerësoi se asnjë prej tyre nuk bazohet në ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

²⁵ *Brumarescu kundër Rumanisë; Pravednaya kundër Rusisë, parag. 25; Bratyakin kundër Rusisë, ndër të tjerë.*

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenet 494 dhe 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, unanimit, për kërkesat me nr. “i”, “ii”, “iii” dhe “v”, dhe me shumicë votash vetëm për kërkesën nr. “iv”,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesave të kërkueses Rovena Gashi, për rishikimin e vendimit nr. 12, datë 29.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të regjistruara si më poshtë:

(i) (JR) nr. 10-20/2018, datë 07.04.2021; (ii) (JR) nr. 16-20/2018, datë 20.10.2021; (iii) (JR) nr. 30-20/2018, datë 06.02.2023; (iv) (JR) nr. 58-20/2018, datë 24.04.2023; (v) nr. prot. 204/232, datë 27.10.2023.

U shpall sot, më datë 06.12.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me vendimin nr. 34, datë 6.12.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të pesë kërkesave të kërkuesses Rovena Gashi për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12, datë 29.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam ndarë mendim ndryshe me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur, arsytimit dhe konkluzionit të arritur, lidhur me kërkesën e katërt të kërkuesses, depozituar në Kolegj më datë 24.04.2023, me nr. 58-20/2018 (JR). Kërkesa e katërt bazohet në vendimin e datës 21.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë dhe të apelit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar²⁶. Referuar këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, kërkuessa pretendon se ndodhet në kushtet e plotësimit të një prej kërkesave për rishikimin e vendimit të Kolegjit, dhënë për të si ish-subjekt rivlerësimi, bazuar në faktin që një nga anëtarët e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e saj në Kolegj, ka kryer një vepër penale dhe është dënuar me vendim të formës së prerë, duke ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e saj të rivlerësimit në kuadër të përcaktimeve të nenit 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile (në vijim “Kodit”).
2. Në vlerësimin tim, kërkesa e katërt e kërkuesses Rovena Gashi plotëson kërkesat e nenit 494, shkronja “c” e Kodit dhe, në këtë rast, mendoj se nuk jemi para asnjë prej parashikimeve të nenit 498 të këtij Kodi për mospranimin e saj, ashtu si ka vendosur shumica e trupit gjykues. Sipas kësaj dispozite të fundit, në rastin konkret kërkesa:
 - është paraqitur referuar shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit;
 - është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 496²⁷ të Kodit, referuar datës së vendimit penal të Gjykatës së Lartë (përmendur në paragrafin 1)²⁸;
 - është paraqitur nga një ish-subjekt rivlerësimi, drejtpërdrejt i interesuar dhe për të cilin vendimi i kundërshtuar ka sjellë pasoja ligjore;
 - nuk është haptazi e pambështetur.
3. Duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësoj se kërkesa e katërt e kërkuesses duhej të pranohej se përbënte shkak për rishikimin e vendimit dhe të kalonte për shqyrtim të mëtejshëm me arsytimin e mëposhtëm.

²⁶ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka gjetur fajtor të pandehurin L. D., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar në nenin 186/1 të Kodit Penal dhe ka dhënë dënimin me 6 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr. {***}, datë 8.3.2021.

²⁷ Neni 496 parashikon se: “Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë”.

²⁸ Edhe pse shumica e trupit gjykues nuk e ka përfshirë në vendim legjitimitimin *ratione temporis* të kërkuesses, si element përbërës të vendimit, provohet që kërkesa është paraqitur brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit.

4. Ndaj mendimin se legjitimimi i kërkueses në rastin konkret, duke paraqitur kërkesën e katërt për rishikim në momentin e marrjes formë të prerë të dënimit penal ndaj gjyqtarit të trupit gjykues të çështjes së saj, si dhe pasi Gjykata e Lartë la sërish në fuqi vendimin e Apelit, edhe pas prishjes pjesërisht të vendimit nga Gjykata Kushtetuese²⁹, vjen në përputhje me përcaktimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Në një interpretim të nenit 494/c³⁰ të Kodit, lexuar literalisht, pa i shtuar kuptime të tjera të tërthorta, të cilat shkronja “c” nuk i ka të shprehura, vlerësoj se duhet të lejohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë kur një anëtar i trupit gjykues ka kryer vepra të dënueshme penalisht që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Në rastin konkret, anëtari i trupit gjykues është dënuar për falsifikim të dokumenteve me të cilat ka aplikuar dhe ka siguruar zgjedhjen e tij si anëtar i Kolegjit, rrethanë/fakt që nuk e legjitimon pjesëmarrjen e tij në trupin gjykues. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), një trup gjykues i cili nuk është formuar “sipas ligjit”, cenon thelbin e procesit të drejtë³¹. Sa i përket ndikimit që ka dënimi penal i anëtarit të trupit gjykues në dhënien e vendimit që i përket kërkueses, vlerësoj se në çdo rast, pjesëmarrja në trupin gjykues e një anëtari që ka kryer një vepër të dënueshme penalisht, ndikon në dhënien e vendimeve të kësaj trupe gjyqësore, për shkak të vesimit nga kryerja e veprës penale. Për më tepër, në rastin konkret, vepra penale e kryer nga ish-gjyqtari është e lidhur drejtpërdrejt me zgjedhjen dhe ushtrimin e funksionit të tij si anëtar i Kolegjit.
6. Për sa më lart, jam e mendimit se shkronja “c” e nenit 494 të Kodit duhet të zbatohet nga Kolegji literalisht, ashtu si është shkruar, çka nënkupton se kjo dispozitë nuk ka parashikuar raste përjashtimore për kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues. Pra, neni 494 i Kodit parashikon rregullime shumë të detajuara dhe në mënyrë shteruese për rastet e kërkesave për rishikim. Po ashtu, edhe dispozitat e tjera të këtij titulli të Kodit³² kanë detajuar afatet dhe procedurën e paraqitjes së kërkesës, gjykatën kompetente që shqyrton kërkesën, kur pranohet apo jo kërkesa për rishikim, procedurën e shqyrtimit etj. Ligjbërësi, duke i kushtuar një rëndësi e kujdes të posaçëm rregullimit në Kod të institutit të rishikimit të vendimit (si në rastin e shkronjës “c”), nuk mund të linte pa rregullim të specifikuar ndonjë përjashtim nga parashikimi i përgjithshëm i shkronjës “c” të nenit 494, duke mos e lënë të nënkuptohet nga zbatuesit e këtij Kodi as kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues dhe as ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore për ndikim në dhënien e vendimit nga trupa gjyqësore.
7. Në ndryshim nga sa shumica e trupit gjykues ka arsyetuar në paragrafin 17.6 të vendimit, vlerësoj se pavarësisht bërjes publike të rrethanave të procedimit penal, të shkeljes ligjore të

²⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 21, datë 26.09.2022.

³⁰ Neni 494/c : “c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit”.

³¹ Në rastin *Dudek v. Germany* (2018), gjykata vendosi që një shkelje e tillë kërkon domosdoshmërisht rishikim, pavarësisht nga ndikimi real i gjyqtarit të dënuar në vendimin përfundimtar. Kjo është për shkak të rrezikut që perceptimi i një padrejtësie në formimin e trupit gjykues, mund të ketë ndikim në besimin e publikut në drejtësi: <https://hudoc.echr.coe.int/tur#%7B%22itemid%22%3A%22001102218%22%7D%3A%3F%3D001%2D102218>

³² Kodi i Procedurës Civile: “Pjesa e tretë”, “Titulli i tretë”, “Rishikimi”, nenet 494 – 500.

gjyqtarit në momentet e zhvillimit të procedurës së zgjedhjes së tij, kërkuesja nuk mund të reagojë për sa kohë që këto shkelje të pretenduara, përbënin vetëm indicie, por nuk ishin identifikuar dhe provuar nga një organ kompetent i specializuar dhe me tagra ligjore të përcaktuara. Vetëm me zhvillimin e procesit të procedimit e gjykimit penal ndaj gjyqtarit dhe provimit të fakteve penale në ngarkim të tij, situata mori veshje ligjore dhe u bë e tillë që mund të shfrytëzohej nga kërkuesja për të ngritur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 12, datë 29.05.2019, të Kolegjit për shkarkimin e saj, ku anëtar i trupit gjykues ishte dhe gjyqtari i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

8. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “Konventa”) garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të paanshëm. Ky parim përfshin jo vetëm përbërjen e trupit gjykues në momentin e dhënies së vendimit, por edhe integritetin personal dhe profesional të anëtarëve të tij. Nëse një gjyqtar është dënuar për një vepër penale, qoftë edhe nëse kjo vepër është kryer jashtë kohës së ushtrimit të detyrës, por në funksion të fitimit të këtij pozicioni, vlerësoj se kjo rrethanë mund të krijojë dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë dhe pavarësinë e tij, duke cenuar të drejtën për një gjykim të drejtë, si dhe duke afektuar procesin e rregullt në vendimin e dhënë nga ky trup gjykues³³. Parë nën dritën e respektimit të Konventës për gjykatën e krijuar me ligj dhe të parimeve të integritetit e paanshmërisë së trupit gjykues, këto janë elemente kyçe për një proces të drejtë dhe çdo dyshim mbi këto elemente vlerësoj se do të kërkonte një rishikim të vendimit për të siguruar që drejtësia jo vetëm të jepet, por edhe të duket që është dhënë.
9. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së dhe lexuar në harmoni me përmbajtjen e nenit 494/c të Kodit, ndaj mendimin se ekziston një detyrim që vendimet e marra nga një trup gjykues që nuk plotëson kërkesat e një gjykate “të krijuar me ligj”, duhet të rishikohen për të siguruar që çdo padrejtësi e mundshme të korrigjohet. Ky pohim, vlerësoj se përbën një masë të nevojshme dhe merr një peshë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri, ku integriteti i procesit të *vetting*-ut, si një proces i jashtëzakonshëm e kalimtar, është thelbësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi, edhe integriteti i trupit gjykues është thelbësor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Çdo shkelje e këtij integriteti, si dënimi penal i një gjyqtari, duhet trajtuar me seriozitet për të ruajtur besueshmërinë e procesit gjyqësor.
10. Kolegji i Posaçëm i Apelit, si organi kushtetues më i lartë dhe e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, si institucioni i pavarur që Kushtetuta³⁴ i ka dhënë atributet e Gjykatës

³³ "Cani v. Albania" (2023) – Ky vendim mbështet argumentin se prezenca e një gjyqtari të dënuar penalisht në trupin gjykues cenon thelbin e procesit të drejtë, duke justifikuar kështu rishikimin e vendimit të formës së prerë: <https://hudoc.echr.coe.int/#{?%22fulltext%22:%22%22CASE%20OF%20BESNIK%20CANI%20v.%20ALBANIA%22%22},%22documentcollectionid%22:%22%22GRANDCHAMBER%22,%22CHAMBER%22},%22itemid%22:%222001-219773%22}}::~text=https%3A/hudoc.echr.coe.int/%3Fi%3D001%2D219773>.

³⁴ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Kushtetuese³⁵ dhe i ka përcaktuar një mision të qartë, si dhe që vendimmarrjet e tij t'i bazojë në parimet e procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të vlerësimit, sipas parashikimeve të Konventës, Kushtetutës, ligjit të posaçëm³⁶ dhe ligjeve të aplikueshme, duhet të demonstrojë e të transmetojë siguri juridike dhe qartësi për ato aspekte të gjykimit që dhënia e drejtësisë i sjell për të zbatuar, sikurse është edhe mjeti i jashtëzakonshëm i rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Në këtë kontekst, zgjedhja e anëtarëve të tij është kryer në mënyrë të tillë për të dhënë imazhin e drejtësisë së re, me profesionalizëm dhe integritet të lartë.

11. Dënimi penal i një anëtari të trupit gjykues për arsye që nuk lidhen me vendimmarrjen e tij, por me kushtet për të qenë anëtar i këtij Kolegji, vlerësoj se cenon standardin e integritetit gjyqësor dhe besueshmërinë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, pozitën vendimmarrëse të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paanshmërinë e tij, si dhe standardin e gjykatës së krijuar me ligj të parashikuar dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në fund të fundit, vendimi penal i formës së prerë ndaj një anëtari të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin e kërkuësës (në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit³⁷, është një fakt i pakundërshtueshëm, i cili në një formë apo në një tjetër implikon sjelljen institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, integriteti institucional i të cilit duhet të mbrohet nëpërmjet zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore që e kanë sanksionuar atë.
12. Në përfundim të këtij arsyetimi, konkludoj se është e bazuar kërkesa e katërt e kërkuësës Rovena Gashi për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

³⁵ Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës parashikon se: “[...] Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”.

³⁶ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

³⁷ Vendimi nr. 48, datë 25.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Gashi.